



PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Titulli i projektit: Monitorimi Publik i Kuvendit të Shqipërisë për Garantimin e Përgjegjësisë Instrukionale dhe Ligjore

Periudha e monitorimit: Raporti Unë Votoj përfshin periudhën Tetor 2013 – Korrik 2015

Qëllimi i raportit

Qëllimi i raportit është ngushtimi i hendekut midis deputetëve dhe votuesve të tyre, promovimi i parimit të llogaridhënies nga ana e deputetëve në shërbim të përmirësimit të imazhit të Parlamentit Shqiptar dhe rritja e pjesëmarrjes publike në proceset politikbërëse e vendimmarrëse.

Monitorimi i Parlamentit (unevotoj.org) ka nisur si iniciativë e Lëvizjes Mjaft! në vitin 2005 me qëllimin që të sjellë qytetarët më afër performancës së parlamentarëve dhe proceseve parlamentare. Duke qenë se një funksionim më i mirë i parlamentit sjell një qeverisje më demokratike, Mjaft e ka ngritur punën e saj sipas një metodologjie gjithëpërfshirëse dhe subjekt përmirësimi të vazhdueshëm në bazë të praktikave më të mira ndërkombëtare dhe nevojës së diktuar nga proceset e brendshme.

Raporti Unë Votoj për periudhën Tetor 2013 – Korrik 2015 shënon publikimin e katërt të Skuadrës së Monitorimit të Kuvendit të Shqipërisë, për legjislaturën e tetë (VIII) parlamentare. Ashtu si në publikimet paraardhëse, raporti përqendrohet në një sërë kategorish dhe indikatorësh, të cilët e kanë burimin nga monitorimi sistematik i seancave plenare dhe mbledhjeve të komisioneve parlamentare, për analizimin dhe vlerësimin e performancës së deputetëve të zgjedhur nga qytetarët në vitin 2013.

I. Metodologjia e ndjekur

Shtyllat kryesore të analizës konsistojnë në:

- Monitorimin e respektimit të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë;
- Analizimin e të dhënave të grumbulluara nga veprimtaria e Kuvendit të Shqipërisë;
- Monitorimin e financave të deputetëve.

Për realizimin e këtij Raporti, Lëvizja Mjaft bazohet në informacionin e mbledhur nga monitorimi periodik dhe sistematik i veprimtarisë parlamentare të ndarë në seanca plenare dhe mbledhje të komisioneve të përhershme parlamentare.

Monitorimi i performancës së Kuvendit të Shqipërisë bazohet në një numër indikatorësh cilësor dhe sasior, siç janë:

- numri i nismave ligjore të shqyrtuara dhe të miratuara,
- numri i seancave dëgjimore me grupet e interesit në fazën e diskutimeve parlamentare për nisma që impaktojnë këto grupe,



- prezenca e deputetëve në punimet parlamentare dhe përfshirja e tyre në diskutime,
- respektimi i procedurës parlamentare,
- ndryshimi i pasurisë së deputetëve.

Mënyra e zbatimit të metodologjisë:

1. Gjatë periudhës së monitorimit Tetor 2013- Korrik 2015, Lëvizja Mjaft, përmes skuadrës Unëvotoj, ka realizuar monitorimin e 380 mbledhjeve të 8 komisioneve të përhershme parlamentare dhe 61 seancave plenare.
2. Gjatë periudhës së monitorimit të veprimtarisë parlamentare të deputetëve në Kuvendin e Shqipërisë, janë rregjistruar nga skuadra UnëVotoj 91 seanca dëgjimore me grupet e interesit të organizuara nga komisionet parlamentare.
3. 214 shkelje të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë janë konstatuar gjatë periudhës së monitorimit.
4. Analiza e pasurisë së deputetëve është realizuar me mbështetjen e një eksperti kontabël. Gjatë procesit të punës janë analizuar 420 deklarata të pasurisë dhe asetëve për 140 deputetët e Kuvendit të Shqipërisë për periudhat e deklarimit 2012, 2013, 2014. Në analizë janë shqyrtuar: të ardhurat familjare; të ardhurat personale; llogari bankare dhe interesa; detyrime nga banka apo palë të treta; totali i pasurisë së luajtshme/palujtshme.

Ky projekt është mbështetur në përmirësimin e metodologjisë së monitorimit dhe përvojës së akumuluar prej vitesh, tashmë nga stafi i Lëvizjes Mjaft nisur dhe nga fakti që ky përbën një iniciativë të aplikuar në disa vite rrjesht.

Të gjitha të dhënat e përfituara nga monitorimi 2 vjeçar i Kuvendit të Shqipërisë administrohen dhe përditësohen në mënyrë periodike në faqen zyrtare të internetit www.unevotoj.org, e cila shërben si një bazë të dhënash publike mbi veprimtarinë e Kuvendit të Shqipërisë, e aksesueshme lehtësisht nga publiku.

Në brendësi të këtij raporti gjenden të dhëna mbi:

- rastet e shkeljes të Rregullores së Kuvendit;
- praninë dhe votimin e secilit deputet për të gjithë nismat ligjore të miratuara;
- deputetët “antikonformistë”, të cilët kanë votuar ndryshe nga pjesa tjetër e grupit parlamentar ku bëjnë pjesë;
- analiza e deklarimit të pasurisë për deputetët e rinj dhe të dhënat mbi shtimin apo pakësimin e pasurisë së deputetëve të mandatuar për të disatën herë.

Respektimi i procedurave parlamentare

Komponenti kryesor i punës së monitoruesve të skuadrës Unëvotoj, tradicionalisht ka qenë sigurimi i respektimit të Rregullores së Kuvendit në çdo mbledhje komisioni apo të seancave



plenare. Gjatë dy viteve të fundit 2013-2015, me ndryshimin e qeverisë, kemi përmirësime në disa aspekte të mbarëvajtjes së Kuvendit, sidomos gjatë vitit të parë (Tetor 2013- Qershor 2014), por kemi gjithashtu mjaft shkelje që vazhdojnë të përsëriten pothuajse në çdo periudhë parlamentare. Një përmirësim të dukshëm evitentojmë sidomos në seancat plenare të monitoruara, ku nuk është rregjistruar asnjë shkelje e nenit 57¹, ku deputetët votojnë për kolegun e tyre. Edhe në raportimet e kaluara, është vlerësuar përmirësimi i situatës mbi respektimin e nenit 57, ndërsa tashmë kjo problematikë konsiderohet e kaluar duke shpresuar në mospërsëritjen e këtij fenomeni. Gjatë dy viteve të fundit 2013-2015, rezultojnë të jenë kryer **65 shkelje të Rregullores** së Kuvendit, përkatësisht neni 57, 34 dhe 62 si **dhe 162 raste të ndryshimit të procesverbaleve të komisioneve parlamentare**, shkelje e cila nuk referohet në asnjë nen të Rregullores së Kuvendit për shkak të natyrës specifike që ka.

▪ **Etika parlamentare dhe moderimi i seancave plenare**

Gjatë legjislaturës së VIII **janë konstatuar 14 raste të shkeljes së Rregullores sa i takon respektimit të etikës parlamentare, c'ka përcaktohet në nenin 62 të saj.** Janë konstatuar disa raste kur fjalori i përdorur nga deputetët konsiderohet i papërshtatshëm për një institucion publik. Ajo ç'ka bie në sy edhe në rastin e shkeljes së këtij përcaktimi të Rregullores është mungesa e dhënies së masave disiplinore për të gjitha rastet e evidentuara.

Duke iu referuar moderimit të seancave plenare nga ish-kryetarja Jozefina Topalli, gjatë Legjislaturës së Kaluar, ishin të shumta rastet ku tejkalonin parashikimet ligjore të kompetencave të postit të përcaktuara në nenin 7 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë. Këtu përfshihej moderimi jo korrekt në reagimet dhe qëndrimet e mbajtura kryesisht ndaj deputetëve opozitar, ndërprerja e diskutimeve dhe të drejtës së fjalës.

Për periudhën dyvjeçare Tetor 2013-Korrik 2015, moderimi i seancave plenare ka qenë korrekt prej kryetarit Ilir Meta në shumicën e rasteve, i cili i është përgjigjur kërkesave për dhënie fjalë të çështjeve proceduriale, apo të drejtë replike, të gjithë deputetëve të Kuvendit. Në këtë periudhë vazhdimisht deputetët që kërkojnë fjalën për çështje të procedurës, nuk i mbahen thelbit të fjalës, si dhe minutazhit të përcaktuar në Rregullore². ***Kjo sjell vonesa dhe shmangie të vëmendjes nga diskutimi i projektligjeve të rendit të ditës, pasi shumë mirë këta deputetë mund dhe duhet të shfrytëzojnë diskutimet për çështje jashtë rendit të ditës.***

Neni 57:

1. Votimi është vetjak.
2. E drejta e votës nuk delegohet.

² Neni 49

1. Për çështje të procedurës fjala jepet menjëherë. Janë çështje të procedurës kërkesat që kanë të bëjnë me zbatimin e Rregullores, kërkesat që përmbajnë propozime për ndryshime ose plotësime të rendit të ditës të miratuar, kërkesat për ndërprerjen ose shtyrjen e seancës plenare ose të diskutimeve, si dhe kërkesat që kanë të bëjnë me mënyrën e marrjes së vendimeve ose kryerjes së votimit.
3. Në këto raste, përveç propozuesit që diskuton jo më shumë se 3 minuta, kanë të drejtë të diskutojnë një folës pro dhe një folës kundër jo më shumë se 2 minuta secili dhe merret vendim me votim të hapur nga Kuvendi me ngritjen e dorës.



Për periudhën Tetor 2013-Qershor 2014, në rastet e mëposhtme, fjalori i përdorur nga të pranishmit përmban gjuhë ofenduese dhe fyese, të adresuara ndaj kolegëve të palës tjetër:

- **Në mbledhjen e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut datë 04 Dhjetor 2013**, gjatë diskutimeve lidhur me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, deputetët Kastriot Islami dhe Xhemal Qefalia u përfshinë në debate dhe akuza personale. Debati degradoi në momentin kur deputeti Qefalia goditi deputetin Islami me një stilolaps.
- **Në mbledhjen e Komisionit për Ekonominë dhe Financat datë 26 Dhjetor 2013**, gjatë debatit midis Kryetarit Erjon Braçe dhe deputetes Albana Vokshi për paketën fiskale, pati përplasje verbale midis dy deputetëve. Në diskutime e sipër, deputeti Erjon Braçe ju drejtua Albana Vokshi, e cila e qortonte për drejtimin e mbledhjes: “...unë mund të jem i aftë të ngre shumë gjëra, por vetëm juve (drejtuar Albana Vokshit) jo...”. Kjo solli acarimin e mëtejshëm të mbledhjes dhe largimin e deputetes Vokshi, por edhe anëtarëve të tjerë të opozitës.
- **Në mbledhjen e Komisionit për Sigurinë Kombëtare datë 28 Janar 2014**, ku i ftuar ishte Ministri i Brendshëm Saimir Tahiri në seancë dëgjimore, në përfundim të mbledhjes deputetët Flamur Noka dhe Pjerin Ndreu shkëmbyen fjalë fyese ndaj njëri tjetrit, ku prej tyre u tentua edhe konfrontimi fizik.
- **Në mbledhjen e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut datë 27 Maj 2014**, për shkak të debateve në komision për raportimin e ministrit të Drejtësisë në përgjigje të kërkesës së deputetit Armando Subashi, lidhur me zbatimin e ligjit nr. 9877, të vitit 2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, dhe ligjit nr. 8811, të vitit 2001, “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”, janë konfrontuar jashtë ambienteve të komisionit deputetët Armando Prenga dhe Gent Strazimiri.
- **Në seancën plenare të datës 10 Korrik 2014**, pas fjalës së mbajtur prej deputetit Gent Strazimiri, në korridoret e Parlamentit është shënuar një incident ku deputetët e mazhorancës Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu janë konfrontuar me deputetin e opozitës Gent Strazimiri. Ndaj deputetëve iniciues të sulmit, në mbledhjen e byrosë u ndërmorën masa për dënimin e tyre, por ky incident solli edhe bojkotin e opozitës për pjesën e mbetur të sesionit parlamentar.

Për periudhën Shtator 2014- Korrik 2015, janë rregjistruar një numër me i madh i rasteve të thyerjes së etikës parlamentare nga ana e deputetëve të Kuvendit, sidomos gjatë seancave plenare, ku akuzat ndërmjet deputetëve janë shtuar duke bërë që diskutimet jashtë rendit të ditës të dominojnë diskutimet në seanca. Një rast i dukshëm në shkelje të procedurave parlamentare është rregjistruar kur një deputet vazhdon dhe flet për 45 minuta për çështje jashtë rendit të ditës. Kjo situatë është bërë gjithmonë e më e zakonshme gjatë seancave plenare.

Rastet konkrete të thyerjes së etikës parlamentare janë paraqitur më poshtë:

- **Në mbledhjen e Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin datë 24 Nëntor 2014**, gjatë diskutimit të projektbuxhetit për vitin 2014, ku ishte i ftuar Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, z. Edmond



Panariti, deputeti Vladimir Kosta u ankua se z. Shalsi nuk e kishte lënë t'i drejtonte pyetje ministrit. Z.Shalsi replikoi duke u shprehur se kur ftoi deputetët të bënin pyetje, z.Kosta nuk e kërkoi fjalën.

- **Në mbledhjen e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë** gjatë seancës dëgjimore me grupet e interesit për diskutimin e deklaratës së dhënë në lidhje me testimin e mjekëve në të gjithë vendin nga Ministri i Shëndetësisë, z. Ilir Beqaj. Gjatë kësaj mbledhjeje janë rregjistruar dy raste të thyerjes së etikës parlamentare. Konflikti i parë ishte midis kryetares së komisionit dhe një prej të ftuarve, z. Kol Nikollës, Kryetarit të Sindikatave në Shqipëri.

Deputetja Vokshi : - “ Kë përfaqësoni ju?

Deputetja Vokshi :- “Ju lutem përgjigjuni a përfaqësoni mjekët?

Deputetja Vokshi :-“ Nëse jo, atehëre nuk ju kam ftuar juve, nuk vihet me dëshirë këtu.”

Z.Nikolla :-“ Zonjë e nderuar, mua më kanë caktuar të vij këtu, ndaj mos m'u drejtoni në këtë mënyrë.”

Deputetja Vokshi :-“ Une përgjigjem si të dua dhe nuk jua jap fjalën. Kuvendi nuk është Pazar që mund të vijë kush të dojë.”

Duke qenë se diskutimi po vazhdonte i vrazhdë, kryetarja e komisionit i kërkoi medias të dalë jashtë për 5 minuta.

Gjatë seancës së pyetjeve, deputetja Mesila Doda mori fjalën dhe filloi të bënte një pyetje që anëtarëve iu duk jashtë teme, duke nisur kështu një diskutim me tone të larta dhe aspak etik.

Eduart Bejko :-“ Zonjë, ju lutem tani, jeni jashtë teme.”

Mesila Doda :-“ Ka mundësi ta qepësh se po flas unë dhe ti s'ke pse ndërhyt.”

Eduart Bejko:-“ Mos më fol mua ashtu!”

Mesila Doda:-“ Mor zotëri, unë jam deputete dhe kam të drejtë të pyes çfarë të dua, më lër të mbaroj.”

- **Në seancën plenare të datës 29 Janar 2015** pati shumë debate gjatë seancës, kryesisht në pikën 3 të rendit të ditës (Akti normativ nr.2, datë 29.12.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014” të ndryshuar). Pati tone të ashpra midis deputetëve të opozitës dhe atyre të mazhorancës, disa kaluan dhe limitet e etikës parlamentare. Gjatë fjalës së ish-kryeministrit Sali Berisha, deputetja Blerina Gjylameti e ofendoi duke e quajtur “hajvan”. Më pas, zoti Spaho në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, e quajti kryeministrin e Shqipërisë “analfabet”, ajo çfarë ai tha konkretisht ishte “Nuk kam parë kryeministër më ekspert se ju në fushën e ekonomisë, u bëra kaq vite profesor ekonomie, shoh që duhen hapur patjetër kurse analfabetizmi.”
- **Në seancën plenare të datës 19 Shkurt 2015-** Ndërkohë që deputeti Taulant Balla dhe ish-Kryeministri Berisha replikonin për korrupsionin në ushtri, ky i fundit iu drejtuar Ministres së Mbrojtjes znj. Kodheli me fjalët “Ministren rëndomtë e thërrasin ‘Ministrja Pilote’, “Mimi Feka”. Zonjë, je e pudrosur nga Major Feka ,



nga pluhurat që transportonte. Ai gjatë periudhës tuaj shkëputej nga misionet që dërgohej dhe nuk raportonte.”

- **Në seancën plenare të datës 9 Prill 2015-** Ish-kryeministri Sali Berisha ka devijuar për rreth 45 minuta, jashtë rendit të ditës për t’u përqëndruar tek deputeti Kokëdhima “*Sot në vend që të ishin të mbledhur për të hequr mandatin, jo imunitetin, por mandatin e Koço Kokëdhimës për grabitjen në dhunimin flagrant të Kushtetutës, në 150 raste të marrjes, përvetësimit të pasurisë publike, gjë që ndalon në mënyrë të prerë Kushtetuta. Kjo kërkesë mbahet në kalendat e dyshes Rama-Meta duke bërë që ju të më dukeni të gjithë sikur të ishit bijtë e nënë Ferides dhe ju të nderuara deputete ministre sikur të ishit vajzat e nënë Feridesë, pasi Koço Kokëdhima ky mumuth i rrjepjes së shqiptarëve, ky njeri për të cilin nuk ekziston ligji, ky debitor i madh i buxhetit të shtetit, ky dhunues flagrant i të gjitha ligjeve të urbanistikës, të mjedisit me ndërtime dhe pronat e tij, tallet me Parlamentin, i sigurtë se kjo shumicë do të kryejë krimin e radhës, të shëmtuar, do mbrojë dhunimin e Kushtetutës nga Koço babëzia, i cili pasi i bëri gjëmën Qeparoit me ndërtime e tij, pasi me tenderët e Edi Ramës vodhi dhe ndau paratë, u binin tavanet nxënësve të shkollave të ndërtuara prej tij dhe ndërtime e tij të paligjshme në Tiranë, tani ka marrë nismën e sivëllait të tij Edi Rama me nënë Feridenë.”*
- **Në seancën plenare të datës 11 Qershor 2015** - Denoncimi i Lëvizjes Socialiste për Integrim për shtimin fiktiv të 600 votuesve në Bashkinë e Vorës, e drejtuar nga Fiqiri Ismaili, derivoi në debate të ashpra midis deputetit Fatmir Mediu dhe Luan Rama. “*Nuk e çova unë të shpërndante miell baxhanakun e Fiqos, që punon në presidencë dhe e kapi policia dje.*” u shpreh deputeti Rama ndaj deputetit Mediu. Debatet e zhvilluara në distancë jashtë mikrofonave ndërmjet deputetëve Rama dhe Mediu përmbanin fjalë fyese. Kërkesa e deputetit Robert Bitri ndaj deputetit Fatmir Mediu që të kthehej para e të mos vazhdonte shkaktoi nervozizëm, ku për të qetësuar situatën dhe për të shmangur përplasjet fizike është dashur ndërhyrja e deputetëve të opozitës.
- **Në seancën plenare të datës 7 Maj 2015** – Një fjalë e thënë nga znj. Nikolla jashtë mikrofonit bëri që deputeti Sali Berisha t’i drejtohej me tone të ashpra “*Nuk ke turp, se të... mbaje gojën. Nuk jam Edi Rama unë. Ti gënjen.*”, debat i cili lidhej me shumën prej 1.2 milionë eurove të përdorura për rindërtimin e Ministrisë së Arsimit.
- **Në seancën plenare të datës 7 Maj 2015** -Gjatë shqyrtimit të projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompesimin e pronës”, të ndryshuar, deputeti Sali Berisha këtë projektligj e cilësoi si “*Neni i mosqeverisjes në dy vjet*”, duke akuzuar qeverinë për marrjen e 18 mijë hektarëve tokë për t’ia kaluar “*Koçove e stërkoçove*”. Gjithashtu, kryetari i grupit parlamentar të PD, zoti Edi Paloka u shpreh “*Ky që ka vendosur në krye vajzën e një ish-anëtari të byrosë politike, Geg Priftit, na thotë ne se jemi e shkuara. Më i shpifuri i shpifarakeve.*”
- **Në seancën plenare të datës 21 Maj 2015** - Diskutime të ashpra pati mes deputetes Jozefina Topalli dhe kyetarit të Kuvendit z. Ilir Meta, ku ky i fundit u akuzua nga znj. Topalli për blerje votash nga LSI-ja në qytetin e Shkodrës. Z. Meta iu përgjigj: “*Shiko, ke folur disa herë në këtë parlament për këtë çështje, sepse ke hallin e zgjedhjeve më 21 Qershor, dhe është e drejta jote. Është e drejta jote të jesh e*



pacipë”, tha në fjalën e tij z. Meta dhe nuk ia dha më fjalën znj Topalli dhe pas insistimit të saj për të replikuar.

II. Vlefshmëria e mbledhjeve në komisionet parlamentare

Gjatë katër viteve të veprimtarisë parlamentare janë monitoruar 380 mbledhje të komisioneve parlamentare. Nga monitorimi i tyre, rezultojnë të jenë miratuar në kundërshtim me nenin 34, pika 1 dhe 2 mbi vlefshmërinë e mbledhjeve të komisioneve parlamentare, **85 nisma ligjore të monitoruara nga** të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë, nisma këto për të cilat duhet të ishin marrë masa për shpalljen e pavlefshmërisë, si dhe duhet të ndërmerreshin masa disiplinore ndaj deputetëve që kanë konsumuar këtë shkelje ligjore.

Mbledhjet e komisioneve parlamentare, të cilat janë zhvilluar në kundërshtim me nenin në fjalë, duke mos plotësuar kuorumin e nevojshëm për miratimin e projektligjeve, janë si më poshtë vijon:

- 14 mbledhje të Komisionit për Ekonominë dhe Financën
- 7 mbledhje të Komisionit të Veprimtarive Prodhuese Tregëtisë dhe Mjedisit
- 7 mbledhje të Komisionit për Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njëriut
- 6 mbledhje e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë
- 4 mbledhje e Komisionit për Politikën e Jashtme
- 1 mbledhje e Komisionit për Integrimin Europian
- 2 mbledhje e Komisionit për Sigurinë Kombëtare
- 0 mbledhje e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik³.

Gjithsesi, duhet theksuar fakti që *ka patur një përmirësim të situatës krahasuar me legjislaturën e VII (2009-2013).*

- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njëriut rezultojnë që në legjislaturën e VII të ketë kryer 5 mbledhje në shkelje të rregullores së Kuvendit sa i takon respektimit të kuorimit, ndërsa për periudhën e monitorimit Tetor 2013 – Korrik 2015 rezultojnë të ketë kryer 7 shkelje në këtë drejtim;
- Situata e ngjashme është konstatuar edhe në Komisionin për Sigurinë Kombëtare, i cili në legjislaturën e VII ka realizuar 1 mbledhje në shkelje të Rregullores së Kuvendit, ndërkohë që gjatë monitorimit për legjislaturën e VIII, 2013-2015 rezultojnë të ketë kryer vetëm 2 shkelje në këtë drejtim;
- Në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë ku vërehet një rritje e shkeljeve të kësaj pike të Rregullores, krahasuar me legjislaturën e VII ku janë regjistruar 1 rast, ndërkohë që për periudhën 2013-2015 është konstatuar vetëm 6 raste.
- **Përmirësimi i dukshëm shfaqet në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese Tregëtisë dhe Mjedisit ku nga 41 shkelje në legjislaturën e XVIII në 7 shkelje në legjislaturën e XIX për periudhën 2013-2015.**

³ Në bazë të të dhënave të monitorimit figurojnë që 60 nga 600 mbledhje të jenë zhvilluar në kundërshtim me përcaktimet e Rregullores së Kuvendit për vlefshmërinë e mbledhjeve të komisioneve parlamentare të monitoruara nga Skuadra UnëVotoj.



Pozitive paraqitet situata në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Ky komision mund të merret si model pozitiv sa i përket respektimit të Rregullores për këtë pikë. Ku zhvillim të mbledhjeve pa plotësuar kuorumin nuk ka.

III. Votimi i deputetëve në seancë plenare

Për këtë periudhë monitorimi *ka patur gjithashtu një përmirësim të dukshëm të situatës lidhur me respektimin e nenit 57 mbi votimin në seancat parlamentare, pikës 1 dhe 2, përcaktohet se: “Votimi është vetjak dhe e drejta e votës nuk delegohet”. Për periudhën tetor 2013-korrik 2015 nuk janë konstatuar raste të votimit për kolegun në krah, ndërsa për legjislaturën e XVIII (2009-2013) numri i rasteve për këtë shkelje ka qenë 12.*

VI. Aktivizimi i deputeteve në mbledhjet e Komisioneve Parlamentare dhe Seancave Plenare.

Në bazë të regjistrimit të fjalëve të deputetëve në seancat plenare përgjatë tetë sesioneve të Legjislaturës së VIII, skuadra e monitoruesve ka përpiluar 10 deputetët më shumë aktivë dhe më pak të tillë. Ky rezultat vjen prej përpunimit të fjalëve të mbajtura prej secilit deputet në diskutimet për çështje të rendit të ditës (si projektligje, akte normative, dekrete etj.), interpelanca dhe diskutime për çështje jashtë rendit të ditës. Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur listat emërore sipas aktivizimit:

Më aktivë	Më pak aktivë
Sali Berisha	Omer Mamo
Edin Rama	Anduel Xhindi
Erion Braçe	Parid Cara
Taulant Balla	Roland Keta
Edi Paloka	Keltis Kruja
Ben Blushi	Alban Zeneli
Eduard Shalsi	Fidel Ylli
Eduard Halimi	Mhill Fufi
Sherefedin Shehu	Besnik Dusha
Jozefina Topalli	Monika Kryemadhi



Gjatë periudhës Tetor 2014 - Korrik 2015 deputetët me aktivë sipas ndarjes nëpër komisione janë:

- **Komisioni për Ekonominë dhe Financat:**

Aktivë: Erion Braçe, Sherefedin Shehu, Dashamir Shehi, Blerina Gjylameti, Ervin Koçi, Ervin Bushati.

Joaktivë: Liljana Elmazi, Majlinda Bufi, Koço Kokëdhima, Luan Duzha, Gledjon Rehovica.

- **Komisioni për Sigurinë Kombëtare:**

Aktivë: Arben Çuko, Flamur Noka, Ardian Turku, Piro Lutaj, Paulin Stërkaj.

Joaktivë: Arben Ndoka, Anduel Xhindi, Keltis Kruja, Alban Zeneli, Ylli Shehu.

- **Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik:**

Aktivë: Alfred Peza, Genc Pollo, Myqerem Tafaj, Mimoza Hafizi, Musa Ulqini.

Joaktivë: Fidel Ylli, Gjovalin Bzheta, Agron Çela, Astrit Veliaj, Enkelejda Shkreli.

- **Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin:**

Aktivë: Eduart Shalsi, Besnik Baraj, Namik Kopliku, Genc Ruli, Ervin Bushati, Gjergji Papa, Helidon Bushati, Artan Gaci, Kozma Dashi, Bujar Derveni.

Joaktivë: Parid Cara, Monik Kryemadhi, Vladimir Kosta, Pirro Kapurani, Besnik Dusha, Agron Duka, Ardian Turku, Sherefedin Shehu, Anduel Xhindi, Gledion Rehovica.

- **Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë:**

Aktivë: Albana Vokshi, Klodiana Spahiu, Petrit Vasili, Ilir Pendavinji, Vangjel Tavo, Eduart Bejko, Ylli Ziçishti.

Joaktivë: Halim Kosova, Roland Keta, Albina Deda, Bedri Miha, Omer Mamo, Enkelejda Shkreli, Florion Mima, Myqerem Tafaj.

- **Komisioni për Integrimin Europian:**

Aktivë: Majlinda Bregu, Taulant Balla, Edi Paloka.

Joaktivë: Esmeralda Shkja, Kejdi Mehmetaj, Arben Imami.

- **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut:**

Aktivë: Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Pandeli Majko, Dashamir Peza.

Joaktivë: Tahir Muhedini, Vexhi Muçmataj, Anila Agalliu.

- **Komisioni për Politikën e Jashtme:**



Aktivë: Arta Dade, Valentina Leskaj, Aldo Bumçi, Fatmir Mediu.

Joaktivë: Luljeta Arapi.

VII. Prezenca fiktive e deputetëve në mbledhjet e komisioneve parlamentare

Një dukuri e evidentuar gjatë periudhës së monitorimit tetor 2013 – korrik 2015 i referohet disa rasteve ku në procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve parlamentare, të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit të Shqipërisë, nuk paraqitet prezenca e saktë e anëtarëve të komisioneve të përherëshme parlamentare. Janë konstatuar **534 raste të ndryshimit të prezencës së deputetëve në mbledhjet e komisioneve**. Nga shkelja e këtij neni derivojnë dy shqetësime: a) kosto financiare fiktive për parlamentin, pasi paguhen deputet të cilët nuk kanë qenë të pranishëm, pra nuk kanë kryer funksionin e tyre; b) zhvillimi i mbledhjeve të pavlefshme, në kushtet e mungesës së kuorumit. Për këto shkelje të konstatuara nga skuadra e monitorimit, në të gjitha rastet, ekzistojnë evidenca me fotografi.

Kostot financiare për 534 emrat e shtuar në lista krijojnë një dëm financiar prej: 1.335.000⁴ lekë.

VIII. Seanca dëgjimore me grupet e interesit dhe shoqërinë civile.

Zhvillimi i seancave dëgjimore me grupet e interesit gjatë shqyrtimit të nismave ligjore përbën një metodë efikase në rritjen e cilësisë së bazës ligjore, por edhe hapjen e debateve për nevojën e ndryshimit të legjislacionit aktual. Mbajtja e seancave dëgjimore është e parashikuar në nenin 36 të Rregullores së Kuvendit, por deri në legjislaturën e kaluar, përdorej rrallëherë nga drejtuesit, por dhe anëtarët e komisioneve. **Për periudhën Tetor 2013-Qershor 2014 vihet re një trend mjaft pozitiv, përse i përket rritjes së zhvillimit të mbledhjeve të komisioneve parlamentare, me grupe interesi nga fusha të larmishme.** Gjithashtu, nuk kanë munguar edhe seancat dëgjimore me përfaqësues të Qeverisë, për të kërkuar llogaridhënie mbi tematika aktuale, si dhe veprimtarinë e tyre mbi baza periodike. Nga të dhënat e monitorimit të skuadrës Unëvotoj, **janë rregjistruar plot 60 seanca të zhvilluara për periudhën në fjalë.**

Nga të dhënat e paraqitura më poshtë, Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin me kryetar z. Eduart Shalsi, mban numrin më të madh të seancave të zhvilluara. Krahasuar me periudhat e mëparshme, puna e këtij komisioni ka qenë më serioze duke u kthyer nga një komision problematik, si për zhvillimin e mbledhjeve pa kuorum ashtu edhe në numrin e vogël të seancave dëgjimore, në një komision model, ku diskutimet konstruktive midis anëtarëve të opozitës dhe mazhorancës kanë prodhuar zgjidhje efikase në shqyrtimin e projektligjeve, por edhe adresimin e problemeve të grupeve të interesit ndaj përfaqësuesve të Qeverisë.

- Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, **ka zhvilluar 20 seanca dëgjimore.**

⁴ 534 emra x 2,500 pagesa për mbledhje = 1.335.000 lekë.



- Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, **ka zhvilluar 9 seanca dëgjimore.**
- Komisioni për Integrimin European, **ka zhvilluar 8 seanca dëgjimore.**
- Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, **ka zhvilluar 8 seanca dëgjimore.**
- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, **ka zhvilluar 6 seanca dëgjimore.**
- Komisioni për Ekonominë dhe Financat, **ka zhvilluar 3 seanca dëgjimore.**
- Komisioni për Politikën e Jashtme, **ka zhvilluar 3 seanca dëgjimore.**
- Komisioni për Sigurinë Kombëtare, **ka zhvilluar 3 seanca dëgjimore.**

IX. Deputetët “ANTIKONFORMISTË”

Në këtë seksion janë paraqitur të pestë grupet parlamentare, të cilët përbëjnë Kuvendin e Shqipërisë. Më poshtë është dhënë përbërja e tyre, si dhe deputetët të cilët janë zgjedhur në postet drejtuese nga kolegët. Gjithsej janë pesë grupe parlamentare, ku dy grupet e majta të Partisë Socialiste dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim formojnë mazhorancën, ndërsa opozita është e përfaqësuar me tre grupe parlamentare, ku grupi më i madh është ai i Partisë Demokratike, i ndjekur nga grupi i Partisë Republikane dhe i Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet.

Për periudhën 1 vjeçare të monitorimit Tetor 2013-Qershor 2014 ka pasur një sërë rastesh të evidentuara të votimit “antikonformist”. Vihet re edhe një rritje të rasteve të votimit “antikonformist” në rradhët e deputetëve të Partisë Demokratike, **ku vetëm për periudhën e mësipërme kemi pesë raste, kundrejt tetë rasteve të evidentuara në të gjithë legjislaturën e mëparshme.** Ndërsa në dy grupet parlamentare të mazhorancës janë rregjistruar një sërë rastesh të deputetëve “antikonformistë”, ku janë propozuar edhe amendime të nismave ligjore. Është për t’u vlerësuar fakti që akoma më shumë deputetë, si nga opozita dhe nga mazhoranca, paraqesin opinionin e tyre ndryshe mbi nismat ligjore nëpërmjet votës dhe diskutimeve, duke kontribuar në rritjen e nivelit të parlamentarizmit.

Më poshtë janë paraqitur të dhenat mbi çdo votim “antikonformist”:

Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste

Grupi parlamentar i Partisë Socialiste është edhe grupi më i madh në Kuvend. Ai përbëhet nga 65 anëtarë dhe së bashku me grupin e Lëvizjes Socialiste për Integrim formojnë mazhorancën për legjislaturën e VIII të Kuvendit të Shqipërisë. Kryetar i grupit të majtë, ashtu si në legjislaturën e kaluar, është deputeti Gramoz Ruçi. Ky grup, gjithashtu, ka edhe katër nënkryetarë, të cilët janë deputetët Eduart Shalsi, Vasilika Hysi, Erion Braçe dhe Taulant Balla. Sekretar i këtij grupi është deputeti Musa Ulqini. Më poshtë janë paraqitur rastet ku deputetë të mazhorancës kanë votuar ndryshe nga qëndrimi i grupit parlamentar:

- Në seancën e datës 7 Nëntor 2013, deputeti Bashkim Fino votoi kundër *Projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10.160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”*. Grupi Parlamentar i PS votoi pro kësaj nisme, ndërsa deputeti Fino paraqiti gjithashtu edhe një amendim për nenin 2, i cili u hodh poshtë me votim elektronik.



- Në seancën e datës 6 Shkurt 2014, deputetja Klodiana Spahiu ka abstenuar mbi *Projektvendimin “Për ngritjen e Komisionit hetimor të Kuvendit për të Kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi gjatë procesit të lëvizjeve të burimeve njerëzore të policisë së shtetit”*. Grupi parlamentar i PS votoi pro, pas një konsensusi me opozitën.
- Gjatë votimit të *Projektvendimit “Për miratimin e përbërjes së komisionit hetimor të Kuvendit për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi gjatë procesit të lëvizjeve të burimeve njerëzore të Policisë së Shtetit”*, në seancën e datës 13 Shkurt 2014, deputeti Dashamir Peza ka votuar kundër këtij vendimi, ndërsa grupi i tij parlamentar u deklarua pro.
- Në seancën e datës 10 Mars 2014, deputeti Dashamir Peza ka abstenuar në votimin e *Projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e privilegjeve dhe imuniteteve të autoritetit ndërkombëtar të shtratit të detit”*. Grupi parlamentar i PS ka votuar pro kësaj marrëveshjeje.
- Në seancën e datës 26 Qershor 2014, deputeti Ben Blushi ka votuar kundër *Projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8872, datë 29.03.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar*, ndërsa Grupi Parlamentar i PS-së ka votuar pro.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Grupi i Partisë Demokratike është grupi më i madh parlamentar opozitar dhe përbëhet nga 41 anëtarë. Ky grup, për legjislaturën e VIII ka zgjedhur si kryetar deputetin Edi Paloka, nënkryetar të tij deputetin Eduard Halimi, e ndërsa sekretar i këtij grupi është deputeti Gent Strazimiri. Numri i deputetëve të Partisë Demokratike është më i madh, por disa prej tyre i janë shtuar grupeve të tjera opozitare, të cilat e kishin të pamundur të plotësonin kuotën e formimit të grupit, me numrin e deputetëve të fituar në zgjedhjet e 23 Qershorit. Më poshtë janë raste të votimit antikonformist prej deputetëve demokratë:

- Në seancën e datës 24 Tetor 2013, deputetja e Eleina Qirici ka votuar pro *Aktit Normativ nr. 6, datë 4.10.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013*. Për këtë nismë ligjore grupi parlamentar i PD ka votuar kundër, ndërsa deputetja Qirici e argumentoi votën e saj ndryshe si gabim për shkak të lodhjes nga punimet e seancës.
- Në seancën e datës 26 Nëntor 2013, deputeti Arben Ristani ka votuar kundër *Projektvendimit “Për mënyrën e trajtimit të deputetëve”*. Për këtë vendim ka abstenuar edhe deputetja Voltana Ademi, ndërsa grupi parlamentar i PD ka votuar pro nismës. Po gjatë kësaj seance deputeti Keltis Kruja ka votuar kundër *Projektvendimit “Për fillimin e procedurave parlamentare për kontrollin e veprimtarisë ekonomike të KLSH-së”*, ndërkohë që grupi parlamentar i PD ka votuar pro.
- Në seancën e datës 12 Dhjetor 2013, në votimin e *Projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar”*, deputeti Eduard Halimi ka abstenuar, ndërsa grupi i tij parlamentar votoi pro.
- Në seancën e datë 30 Janar 2014, deputeti Aldo Bumçi ka abstenuar në votimin e dy projektligjeve të mëposhtme, ndërkohë që grupi i PD ka qenë pro nismave. *Projektligji i*



parë ishte ai “Për ratifikimin e Konventës C187 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) “Për kuadrin promociional të sigurisë dhe të shëndetit në punë”, 2006”. I dyti ishte Projektligji “Për ratifikimin e konventës C167 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) “Për sigurinë dhe shëndetin në ndërtim”, 1988”.

- Në seancën e datës 22 Maj 2014, deputetja Jozefina Topalli ka votuar kundër *Projektligjit “Për sigurimin e depozitave”*. Ndërsa gjatë votimit të këtij projektligji Grupi Parlamentar i PD-së ka votuar pro.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Socialiste për Integrim

Ky grup parlamentar është i treti për nga madhësia në Kuvendin e Shqipërisë për legjislaturën e VIII dhe përbëhet nga 17 deputetë. Kryetari i këtij grupi është deputeti Petrit Vasili, ndërsa në pozicionin e nënkryetarit janë tre deputetë, Monika Kryemadhi, Kejdi Mehmetaj dhe Përparim Spahiu. Ndërsa sekretare e grupit të Lëvizjes Socialiste për Integrim është deputetja Miranda Rira. Deri në muajin Qershor të vitit 2014, janë dy raste të evidentuara të votimit antikonformist për deputetët e LSI:

- Në seancën e datës 14 Nëntor 2013, deputetja Monika Kryemadhi ka abstenuar në votimin e *Dekretit nr. 8383, datë 08.11.2013 “Për kthimin e ligjit nr.161/2013 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 5, datë 30.9.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”*, ndërsa grupi parlamentar i LSI ka votuar kundër tij.
- Në seancën e datës 6 Shkurt 2014, deputetët Monika Kryemadhi, Silvi Caka dhe deputeti Spartak Braho kanë votuar kundër *Projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit hetimor të Kuvendit për të Kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi gjatë procesit të lëvizjeve të burimeve njerëzore të policisë së shtetit”*. Për këtë nismë ndryshe nga grupi parlamentar kanë votuar edhe Luan Rama dhe Bujar Kllogjeri të cilët kanë abstenuar, ndërsa grupi i LSI ka votuar pro ngritjes së komisionit hetimor.

Grupi Parlamentar i Partisë Republikane

Partia Republikane siguroi tre mandate në zgjedhjet e fundit parlamentare, por edhe deputetin, si dhe kryetarin e kësaj force Fatmir Mediu, në listat e Partisë Demokratike. Për formimin e këtij grupi parlamentar u bashkuan edhe tre deputetët e Partisë Demokratike Mhill Fufi, Besnik Dusha dhe Bedri Hoxha. Kryetar për këtë legjislaturë do të jetë deputeti Fatmir Mediu, nënkryetar deputeti Agron Duka, ndërsa sekretar deputeti Ylli Shehu. Në vetëm një rast ka rezultuar votim antikonformist për grupin republikan, rasti i cili siç shpjegohet edhe më poshtë ka qenë aksidental:

- Në seancën parlamentare të datës 24 Tetor 2013, deputeti Mhill Fufi ka votuar pro *Aktit Normativ nr. 6, datë 4.10.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013*. Grupi në të cilin ai bën pjesë është shprehur kundër, ndërsa deputeti Mhill Fufi e ka cilësuar votën e tij një gabim njerëzor, pasi edhe ai ishte kundër nismës.

Grupi Parlamentar i Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet



Grupi i pestë parlamentar i Kuvendit është ai i PDIU. Kjo forcë politike siguroi katër deputetë në zgjedhjet e 23 Qershorit, por edhe një mandat të kryetarit Shpëtim Idrizi, i cili ishte kandiduar në listat e Partisë Demokratike. Kështu për të formuar grupin e tyre parlamentar, u bashkuan edhe dy deputetët e partisë aleate, Alban Zeneli dhe Gjovalin Bzhetaj. Kreu i këtij grupi është deputeti Shpëtim Idrizi, nënkryetar deputeti Dashamir Tahiri, dhe sekretar deputeti Tahir Muhedini. Edhe ky grup parlamentar ka rezultuar në vetëm një rast për votim kundra linjës së grupit. Por përgjatë fundit të sesionit të dytë, grupi i deputetëve të PDIU u shkëputën disa herë nga linja e opozitës duke qënë të pranishëm në votimet e projektligjeve si dhe duke votuar pro tyre.

- Në seancën e datës 24 Prill 2014, deputeti Aqif Rakipi ka votuar pro projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publikë” të ndryshuar”, ndërsa opozita dhe Grupi Parlamentar i PDIU ka votuar kundër nismës.

Për periudhën Shtator 2014-Korrik 2015 janë paraqitur këto raste të votimeve “antikonformiste”:

Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste

- *Komisionin për Çështjet Ligjore , Administratën Publike dhe të Drejtat e njeriut , datë 25 Mars 2015, deputeti Dashamir Peza votoi kundër projektligjit “Për heqjen nga fondi pyjor dhe kullotsor Kombëtar të sipërfaqes dhe zvogëlimin në vëllim të fondit pyjor Kombëtar në ngastrat e ekonomive pyjore “Gojan – Shkozë”, “Gjegjan – Shkozë”, “Lumi I Zi”, “Lugina e Fanit të Madh”, “Qafëmollë”, “Fang”, “Spaç” dhe “Shkallgjanë”, të cilat preken nga ndërtimi i Hidrocentraleve në Gojan Gjegjan, Peshqesh, Ura e Fanit dhe Fang, që do të ndërtohen nga shoqëria “AYEN AS ENERGY”, sh.a” duke argumentuar se ky projektligj ul rezervën pyjore të vendit.*
- *Seanca plenare 24 dhjetor 2014, Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9665, date 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”= 75 vota pro, 50 kundër dhe 1 abstenim. Deputetja Arta Dade abstenoj.*

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

- *Seanca plenare 5 shkurt 2015, Projektligji “Për një ndryshim në aktin normativ me fuqinë e ligjit nr.4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, të miratuara me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008. Votuan pro projektligjit: Albina Deda, Agron Duka, Halim Kosova, Bedri Mihaj, Gjergji Papa, Arben Ristani, Dashamir Shehi, Ardjan Turku. Ndërsa deputeti Florion Mima abstenoj*
- *Seanca plenare 2 Prill 2015, Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Deputetja Majlinda Bregu votoi pro.*



- *Seanca plenare 28 Maj 2015*, Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”. Deputeti Astrit Veliaj votoi pro.
- *Seanca plenare 9 Korrik 2015*, Projektligji “Për miratimin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë”. Deputeti: Dashmir Shehi abstenoj.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Socialiste për Integrim

- *Seanca plenare 23 Tetor 2014*, Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.= 72 vota pro, 1 kundër dhe 0 abstenim. Deputeti Spartak Braho votoi kundër.

Grupi Parlamentar i Partisë Republikane

- *Seanca plenare 7 Maj 2015*, Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompesimin e pronës”, të ndryshuar. Deputeti Fatmir Mediu abstenoj.

Grupi Parlamentar i Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet

- *Seanca plenare 30 Tetor 2014*, Projektligji “Për njoftimin dhe konsultimin publik=79 vota pro, kundër , 0 abstenim. Deputeti Aqif Rakipi votoi pro.
- *Seanca plenare 30 Tetor 2014*, Projektligji “Për shërbimin e urgjencës mjekësore”=79 vota pro, 0 kundër , 0 abstenim. Deputeti Aqif Rakipi votoi pro.
- *Seanca plenare 6 Nëntor 2014*, Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e shërbimeve mjedisore”= 79 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Deputeti Aqif Rakipi votoi pro.
- *Seanca plenare 6 Nëntor 2014*, Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim që vepron si Agjenci zbatuese për Fondin Global të mjedisit për projektin e shërbimeve mjedisore”= 80 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Deputeti Aqif Rakipi votoi pro.
- *Seanca plenare 5 Shkurt 2015*, Projektligji “Për një ndryshim në aktin normativ me fuqinë e ligjit nr.4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënie në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, të miratuara me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008. Deputetët Shpëtim Idrizi, Omer Mamo, Tahir Muhedini, Aqif Rakipi dhe Dashami Tahiri kanë votuar

X. Analiza e deklaramit të pasurisë për deputetët

Procesi i analizimit të pasurive të deputetëve është mjaft i rëndësishëm sa i përket përpjekjeve të institucioneve përgjegjëse, mediave dhe shoqërisë civile, për të ndikuar pozitivisht në uljen e korrupsionit, minimizimin e rasteve të konfliktit të interesit dhe fshehjen e pasurisë të deputetëve



të Kuvendit të Shqipërisë. Qëllimi i këtij komponenti nuk është mbivendosja e punës së institucionit të Inspektoratit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive, por është ndihma që shoqëria civile dhe Lëvizja Mjaft synojnë t'u japin institucioneve të pavarura në luftën kundër korrupsionit. Vlera e shtuar që Mjaft sjellë me këtë komponentë lidhet me informacionin që mjaft siguron nga denoncime të qytetarëve apo informacione të ndryshme të medias në lidhje me pasuri të fshehura të deputetëve si dhe burime të tjera financiare të pa deklaruar nga deputetët. Këto informacione ballafaqohen me asetet e deklaruar dhe nëse nuk rezultojnë të deklaruar u dërgohen ILDKP si indicie për nisjen e një verifikimi.

Në këtë pjesë të raportit pasqyrohen të ardhurat dhe pasuritë për secilin deputet që ka shërbyer gjatë periudhës 2012, 2013, 2014. Ky informacion mbështetet mbi deklaratën personale të secilit deputet dorëzuar në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (ILDKP). Për periudhën në fjalë janë analizuar 420 deklaramë të pasurisë së deputetëve, prej të cilave janë nxjerrë diferencat ndërmjet pasurisë së akumuluar dhe detyrimeve ndaj palëve të treta (banka ose hua nga individ).

REKOMANDIME

Përsa i takon respektimit të Rregullores së Parlamentit

Bazuar në përcaktimet ligjore mbi “publicitetin e mbledhjeve të komisioneve parlamentare dhe seancave plenare” rekomandojmë ndërmarrjen e hapave deburokratizuese në ndjekjen e punimeve parlamentare nga qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit, në dobi të transparencës së institucionit dhe rritjes së përgjegjshmërisë përmes monitorimit të vazhdueshëm të institucioneve publike. Për zgjidhjen e këtij problemi rekomandohet miratimi i një ligji specifik që të do garantojë në mënyrë ligjore përfaqësimin e grupeve të interesit në dëgjesa publike parlamentare sa herë që Kuvendi i Shqipërisë do të shqyrtojë çështje të cilat prekin në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të terthortë këto grupe.

Do të sugjeronim rritjen e masave kontrolluese për pjesëmarrjen e deputetëve në punimet parlamentare dhe ndërmarrjen e masave disiplinore për personelin administrativ që përfshihet në rastet e ndryshimit të prezencës së deputetëve në punimet parlamentare.

Përsa i takon respektimit të etikës parlamentare

Për këtë çështje kërkohet një angazhim më i madh për respektimin e etikës parlamentare dhe një maturi më e lartë nga ana e klasës sonë politike për të zgjidhur debatet dhe kundërshtitë politike ndërmjet tyre në mënyrë të qytetëruar dhe pa tejkalluar normat dhe rregullat e etikës që ekzistojnë në një institucion si Parlamenti i cili duhet të ushqejë kulturën e debatit dhe të kompromisit në respektim të ligjit për interesat e vendit. Gjithashtu, nevojitet që strukturat përkatëse të Kuvendit të Shqipërisë të angazhohen në parandalimin e sjelljeve dhe veprimeve jo etike, nëpërmjet masave disiplinore për deputetët.

Përsa i takon prezencës së deputetëve dhe cilësisë së diskutimeve në Kuvendin e Shqipërisë



Prezenca e deputetëve në mbledhjet e komisioneve parlamentare dhe seancave plenare duhet të jetë më e lartë si dhe diskutimet që kryhen për projektligjet apo çështjet që trajtohen në Kuvend të jenë më cilësore. Ky sugjerim vjen nga përvoja në monitorimin e veprimtarisë parlamentare ku në disa raste konstatohet se diskutimet parimore dhe teknike për çështje të caktuara kthehen në debate për çështje që nuk lidhen me objektin e diskutimit duke kaluar në akuza reciproke, c'ka pasqyron një mungesë të theksuar etike, profesionalizmi dhe serioziteti.

Përsa i takon moderimit të seancave plenare

Duke synuar rritjen e performancës parlamentare dhe përmirësimin e cilësisë së diskutimeve, gjejmë me vend të sugjerojmë respektimin rigoroz të nenit 7 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, ku përcaktohen qartë kompetencat dhe përgjegjësitë e pozicionit të Kryetarit të Kuvendit, si drejtues, moderator dhe mbarëvajtës i punimeve parlamentare.

Ky raport është një botim i Lëvizjes MJAFT! në kuadër të Projektit Monitorimi Publik i Kuvendit të Shqipërisë për Garantimin e Përgjegjësisë Institucionale dhe Ligjore.